



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

Nr. 1697/Prot.

Tiranë, më 26.02. 2026

UDHËZIM

Nr. 4, datë 26.02. 2026

PËR

DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 8, DATË 3.5.2024 “PËR PROCEDURAT E PRANIMIT, TË PEZULLIMIT DHE TË LARGIMIT TË MËSUESIT NGA NJË VEND PUNE, SI DHE ADMINISTRIMIT TË PORTALIT “MËSUES PËR SHQIPËRINË”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 4 të nenit 60 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe urdhrit nr. 578, datë 11.11.2025, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit, znj. Orjana Osmani”,

U D H Ë Z O J:

1. Në udhëzimin nr. 8, datë 3.5.2024 “Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:
 - a) Kudo në udhëzim togfjalëshi “Ministria e Arsimit dhe Sportit” dhe akronimi “MAS” të zëvendësohen me fjalët “Ministria e Arsimit” dhe “MA”.
 - b) Pika 3, e Kreut I, ndryshon si më poshtë:

“3. Portali “Mësues për Shqipërinë” krijohet për punësimin e mësuesve në arsimin parauniversitar bazuar në meritë, transparencë, shanse të barabarta dhe në planifikimin me efikasitet të burimeve njerëzore”.
 - c) Pika 5, e Kreut III, ndryshon si më poshtë:

“5. Kandidati aplikon në DRAP-në ku ka vendbanimin e përhershëm. Ai ka të drejtë të përzgjedhë deri në tri ZVAP ku dëshiron të punësohet, brenda DRAP-it ku ka vendbanimin e përhershëm”.
 - ç) Në pikën 12, të kreut IV pas togfjalëshit “të të gjitha profileve” të shtohet togfjalëshi “brenda të njëjtit DRAP”.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, institucionet

arsimore rajonale përgjegjëse për arsimin parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare publike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI

